

MISTICIZMI, TARIKATET DHE DISA PËRFAQËSUES

Misticizmi është ajo dituri që merret me gjendjen shpirtërore të njeriut, ku mendja pushon së luajturi rolin e vet, funksionin e të gjykuarit e kur njeriu zbulon disa të vërteta hyjnore që nuk ka mundur t'i arrijë me rrugë tradicionale e metoda filozofike. Që nga shekujt më të lashtë, dijetarët e kohës janë marrë me këtë problem me aq sa ua lejonte shkalla e tyre e zhvillimit kulturor. Misticizmi ka si kërkesë të parë mohimin e çdo gjëje, përveç Zotit.¹ Tesavvufi është disiplinë përtej arsyes dhe që mësohet në procesin e edukimit.² Tesavvufi është pastrimi i shpirtit.³

Dr. Selçuk Eraydin, në librin e tij "Tesavvufi dhe tarikatet" shkruan: "Botëkuptimi mistik është dukur herët tek "të diturit" e shoqërive të para në histori, por në trajta të ndryshme.

Indusët përvojën mistike e kanë prezantuar nëpërmjet brahmanëve, ithtarëve të Brahmës.

Arius-ët,⁴ lexo arias-ët (kështu quheshin murgjit indus), ishin kategoria më e lartë e mistikëve indianë. Ata qëndronin vazhdimisht në faltore, ku merreshin me predikime dhe kryenin shërbesa fetare. Indianët në fillim besonin në një Zot të vetëm, që në gjuhën sanskritishte quhej Brahma. Mendimi mistik i tyre përmbledhë në besimin se shpëtimi i njeriut arrihet me vdekjen e vullnetshme. Në ndryshim me fetë e tjera, indianët besonin edhe në kalimin ose emigrimin e shpirtit pas vdekjes nga një trup në tjetrin, besonin në *reincarnacionin*.

Egjiptianët e lashtë, kur bëhej fjalë për mistikën, i referoheshin Hermes Tothit, për të cilin është hedhur mendimi se është profeti Idris.

Ndërsa grekët, në mistikën e lashtë përfaqësohen nga Pitagora, Sokrati, Platoni; hebrejtë me Kaballën; të krishterët me misticizëm, kurse në Islam, kjo ide e lartë është prezantuar brenda disiplinës së tesavvufit."⁵

Misticizmi e tesavvufi

Në këtë kuadër, dijetarët muslimanë kanë bërë përpjekje të ndërtojnë përkufizime sa më të kuptueshme, ku të përmbledhen veçoritë më thelbësore të kësaj fushe të dijes: "Tesavvufi është përqafimi i Kuranit e i Sunetit".⁶

Dhunnun Misri (vd. 245 /859),⁷ një nga mistikët e parë islamë në Egjipt, thotë: "Personi që me veprat, sjelljen dhe moralin e vet ndjek sunnetin e Pejgamberit, Muhamedit (a.s.), shpreh dashurinë ndaj Zotit."

Ebu Muhammed Xheriri (vd. 311/923) thotë: "Misticizmi është përvetësimi e të gjitha virtyeteve të mira dhe largimi nga të gjitha veset e këqija".⁸

Në ditët tona zhvillohen kërkime të niveleve më të përparuara e cilësore. Po kështu, tani, në kohën tonë ka universitete që kanë themeluar fakultete e katedra shkollash të larta me studentë e pedagogë të profilizuar për disiplinën e misticizmit, teksa botohen me shumicë metodika dhe literaturë plotësuese në ndihmë studentëve apo për publikun e gjerë.

E përbashkëta, ajo që i bashkon këto përkufizime, është prirja e nënshtrimit të plotë të mistikut ndaj urdhërave dhe ndalesave të Zotit, stolisja e njeriut me moralin e Allahut e të Resultit dhe largimi i zemrës së tij prej gjërave, përveç Allahut.

Me shfaqjen e Islamit, ndryshuan metodat e të menduarit mbi jetën shoqërore, konceptet mbi jetën dhe qëllimin e saj, mbi shpirtin, mbi filozofinë etj.

Në fund të shek. VI dhe në fillim të shek. VII, rreth vitit 610 pas Krishtit, Muhamedi (a.s) u shfaq me mesazhin hyjnor. Së bashku me "zbritjen" e verseteve kuranore, ndryshuan: botëkuptimi filozofik, mentaliteti dhe besimi i njeriut; si rrjedhojë, edhe bota e brendshme e ezoterike e njeriut. Po lindte logjika dhe gjykimi i brendshëm ezoterik islam, me fjalë të tjera, "Tesavvufi".

Historiani i mirënjohur musliman, Ebul Fida,⁹ shpreh mendimin se ata njerëz të Zotit që u quajtën "As'habi safa"¹⁰ (të afërm të familjes), ata të varfër, të huaj pa mbrojtje e pa shokë që zgjodhën mësimet e të Dërguarit të Allahut, qenë brezi i sufiteve të parë; streha e Tempullit u bë vendbanimi i tyre. Kur

Profeti (a.s.) shkonte për të ngrënë, ftonte shumë prej tyre që ta shoqëronin në ushqim e disa i dërgonte me shokët, me as'habët. Këta 40 e ca burra në Kuran emërohen me epitetet: Mukarrrebin (të afërmit e Allahut xh.sh.), Abrar (njerëz të virtytshëm), Zahid (asket).

Autori i librit "Ghijathul-Lugha (Ndihmës i gjuhës)" etimologjinë e fjalës "saf" e shpjegon me "suffa", emër i një fisi arab para kohës së Islamit. Ky fis mori përsipër të shërbente në mirëmbajtjen e tempullit të Mekës, kurse Ebul Fida shkruan se "As'habus safa" e morën emrin nga fjala arabe "suf" (lesh), por ka edhe një mendim se ata e morën emrin nga fjala arabisht "saff" (radhë, rresht)."¹¹

Dijetarët islamë, si persona zahidë në radhën e sufive, rendisin katër shokët e parë të Muhamedit (a.s.) të cilët kanë gëzuar shkallë të larta mistike. Pedagogu i Medresesë, sheh Qazim Hoxha shkruan: "*Ebu Bekrin, ishte në mekami beka¹² dhe shikonte me të dy sytë, me të hakikatit e me të shariatit.*" Në këtë kontekst, Qazim Hoxha këtë ofiq ja pohon edhe së nderuarës zonjës së madhe Aishe, bashkëshortes së Profetit (a.s.).¹³

Aktivizimin e të katër as'habëve të mëdhenj: Ebu Bekër, Ymer, Osman e Ali në shoqërinë e "As'habus Safas" e në botëkuptimin e tesavvufit sunit e pohon edhe Hasan Kamil Yillmas.¹⁴ *Tesavvufi* në Islam konceptohet si "zuhd". Zuhd quhet largimi prej çdo gjëje, përveç Zotit. Ky është përkufizimi më konciz i misticizmit e ndoshta edhe më i sakti. Megjithëkëtë studiuesit i kanë shtrirë më tej kërkimet dhe kanë veçuar karakteristikat e tesavvufit, nga të cilat ajo më kryesorja është "Njohja e Zotit (xh.sh)". Pastaj vijnë përgatitja morale, pastrimi i zemrës, disiplina ezoterike etj.

Lind pyetja se ku përputhen e ku ndryshojnë mes tyre dy kategori filozofike, si: tesavvufi dhe misticizmi në aspektin logjik.

Tesavvufi është konsideruar si kulmi, bërthama, esenca e shkencave islame. Përvoja mistike e emërtuar "Hajl" (gjendje) në tesavvuf përfaqëson anën e shijimit dhe të ndjeshmërisë së lartë. Sipas atyre që e emërtojnë etikë, mund të paramendohet si një disiplinë islame, që ka për qëllim sendërtimin e pjekurisë morale dhe virtyteve më të mira të njeriut. Subjekti i tesavvufit

është Allahu (xh.sh), ekzistenca, cilësitë dhe vepra e tij. Tesavvufi mësohet nëpërmjet një cikli ushtrimesh praktike nën mbikqyrjen, drejtimin dhe udhëheqjen e prijësit. Ai është përcaktuar si jeta shpirtërore e krijesës dhe si institucionalizimi i autoritetit kuptimor të Pejgamberit (a.s.).

1. Tesavvufi i mundëson njeriut ngritjen shpirtërore, kurse në misticizëm ka pasione përkohshme .

2. Në misticizëm ka rëndësi tortura e vetvetes, gjë që në tesavvuf kjo nuk ka vlerë.

3. Metodatat e edukimit në tesavvuf dallohen në vartësi me individin. Kjo do të thotë se merren parasysh edhe veçoritë individuale të personit që futet në botën mistike, në studime, e probleme të tjera që kanë të bëjnë jo vetëm me praktikimin e tesavvufit, por edhe të studimit të saj si disiplinë; ndërsa misticizmi nuk e merr parasysh këtë faktor.

4. Baza e ngritjes shpirtërore në tesavvuf është përpjekja individuale, ndërsa misticizmi nuk e njeh këtë nevojë.

5. Mistiku është ndjekës i ekstazës; sufiut i duhet gjendje mendore e kthjellët dhe gjykim i shëndoshë, brenda normave të diturisë.¹⁵

6. Së fundi, Islami e ka ndaluar murgërinë, heqjen dorë, largimin prej problemeve të kësaj bote.¹⁶

Natyrisht që këto ballafaqime nuk janë absolute e të prera me thikë. Formulimet e dijetarëve lindorë u janë shtruar diskutimeve të hollësishme. Praktikohen dendur prova me njerëz të gjallë, të zellshëm për të marrë vullnetarisht mbi vete detyra relativisht të vështira për një palë njerëzish që janë mësuar me rehatinë dhe qetësinë optimale të jetës komode. Muslimanët praktikojnë "itiqafin", dhjetë ditët e fundit të muajit të Ramazanit, nëpër xhamitë. Itiqafi është një lloj izolimi që mund ta aplikojë çdo musliman, duke jetuar në mjediset e xhamisë, i angazhuar me lutje e adhurime plotësuese, që synojnë kalitjen e ndërgjegjes, përsosjen shpirtërore etj. Itiqafi është një imitim i përkohshëm i jetës së mistikëve të përkushtuar në bazë të rregullave e dispozitave të posaçme islame. Itiqafi praktikohet edhe në xhamitë e Tiranës në ditët tona.

Obligimet, urdhërat, porositë e sheriatit, si edhe ndalesat, mistikët i ndajnë në dy grupe:

1.- Ekzoterike (zahiri, të dukshme) janë ato vepra e veprime që njeriu i kryen me gjymtyrët dhe organet e tij (me dorën, këmbën, veshin, syrin etj). Me këto organe e gjymtyrë ai ecën, shkon në haxh, agjëron, fal namazin ose ndalohet të kryejë krime, të vjedhë, veprime që kryhen me këto organe e gjymtyrë.

2.- Ezoterike (batini, të fshehta). Në këtë kategori hyjnë: besimi te Zoti, durimi, falenderimi etj. Këto veprime realizohen me mendje, zemër dhe me ndërgjegje. Profeti jepte shembullin e asketit dhe gëzonte vetitë e virtytet morale më të mira humanitare. Dashurinë për njeriun, në emër të Allahut, ai e sendërtonte me bujarinë, duke e ndarë me të varfërit kafshatën e bukës. Vishej thjesht, me rroba të arnuara, kishte mëshirë për krijesat dhe kurrë nuk krenohej. Këto cilësi janë pjesë e moralit të mistikut. Ai fitoi besimin, respektin e dashurinë e pakufishme të të gjithëve.

“Asnjërit nga perandorët me kurorë nuk u është bindur bota, sikurse këtij njeriu me xhybe e këpucë të arnuara me duart e veta....”
“...Orenditë e shtëpisë së tij ishin të thjeshta; ushqimi kryesor i tij ishte buka e uji”, - shkruan Thomas Carcyle, një filozof anglez i shek.XIX.¹⁷

Studiuesit dhe autorët e botimeve shkencore të filozofisë e të mistikës islame e kanë gjurmuar së afërmi përvojën e mistikëve. Mendimi sufik i bazuar në Kuran e në Hadith me veprat e shkruara, është thelluar e sistemuar më tej. Burimet kryesore të tesavvufit,¹⁸ që kanë shërbyer edhe si burim i librave të mëvonshme, janë:

-Haris b. Esed Muhasibi (vd. 243/857) me librin “Er riaje li hukukilah (Kujdesi për të drejtat e Allahut)”. Është sufiu i parë veprat e të cilit i kemi edhe sot.

-Hakim Tirmidhi, (vd. 320/932), me veprën “Hatmul-Velaje (Vula e shenjtërisë)”. Është ndër përfaqësuesit e parë të mendimit sufik.

-Ebu Bekr Kelabazi (vd. 380/990), me veprën “Et Taarruf (Njohja)”, në të cilën së bashku me temat e besimit ka sqaruar edhe termat në lidhje me tesavvufin.

-Muhammed Gazali (vd. 505/1111): Vepra kryesore e tij është “Ihjau Ulumid-din” (Ripërtëritja e dijeve fetare)”. Ka qenë mjeshër në apologjetikë, filozofi dhe tesavvuf, po në fund është

vendosur në tesavvuf.

-Mevlana Xhelaluddin Rumi, (vd. 672/1273). Një nga veprat e tij kryesore është "Mesnevia (Dy nga dy)." Mistiku Rumi u afirmua si poet, njohës i disa gjuhëve, autor i disa veprave me famë botërore.

Në këtë renditje figurash të dijes janë lënë jashtë shumë dijetarë e mistikë e janë kapërcyer plot detaje. Përmendim p.sh. Gazaliun, që zë vend të veçantë midis tyre. Vepra e tij "Ihjaul Ulumid Din" (Ringjallja e diturive fetare) trajton problemet e Islamit në një fazë të përparuar të kërkimeve islame nga dijetarë të Lindjes e të Perëndimit. Autori ka dituri të gjera rreth ecurisë së Islamit në shek.XII dhe shikon një gjallërim të shkencave, një ripërtëritje,¹⁹ një intensifikim të gjurmimeve dhe ndien nevojën e ecjes në drejtim vertikal, në thellimin e diturive fetare, pa i ndarë në janë të spektrit ekzoterik (të dukshme) apo të atij ezoterik (të fshehta). Misticizmi islam shtron para mistikut rregulla, dispozita, kërkesa që duhen zbatuar. Midis tyre, është edhe një "nen" me emrin "tevekkul". Tevekkul i thonë asaj bindjeje, atij besimi që njeriu ta ndiejë veten të dorëzuar plotësisht para Zotit. Këtë premisë mistike Imam Gazaliu e shpjegon kështu: Njeriu përpara Zotit duhet ta ndiejë veten e të qëndrojë ashtu siç qëndron i vdekuri para duarve të personit që lan kufomat e të vdekurve muslimanë. Dispozita të tilla ka shumë, por neve që nuk e kuptojmë metodikën e ndërtuar të disiplinës së tesavvufit, na duken të parëndësishme. Shumë tema të tilla i ka marrë në shqyrtim analisti i ri egjiptian, Muhammed Ali Karaati, në librin e tij me titull "Ihjaul Gazali" ("Ripërtëritja në optikën e Gazaliut"), ku bën fjalë edhe për tevekkulin.²⁰

Gazaliu ka njësuar drejtësinë islame me tesavvufin, thotë një analist. Në jetën e tij ky dijetar i madh ka përjetuar periudha krize intelektuale, që e larguan përkohësisht nga shkolla (viti 1095 pas Krishtit). Djaloshi student, kolosi i ardhshëm i shkencave islame, arriti të mohonte çdo gjë brendapërbrenda vetvetes, por jo Allahun (xh.sh.).

Gazaliut iu desh të merrte rrugët e mërgimit nëpër disa vende të përparuara, derisa bota e tij mistiko-filozofike u normalizua dhe u qetësua, për të vijuar aty ku e kishte lënë veprën kërkimore kijuese dhe u vendos në Nishapur, ku punoi

derisa vdiq më 1111 pas Krishtit, i nderuar nga nxënësit e tij dhe nga masat muslimane. Kriza intelektuale e Gazaliut të kujton filozofin e madh francez, Rene Decart (1596-1650), që *dyshonte për çdo gjë, deri në veten e vet. Pas dyshimit, filozofi zbuloi parimin e famshëm: "Cogito ergo sum", që do të thotë: "Meqë mendoj do të thotë se jam" dhe deklaroi: "Kaq i bindur jam në ekzistencën e Zotit, sa jam i bindur që shuma e këndeve të një trekëndëshi është e barabartë me dy kënde të drejtë."* Dekarti dyshoi në vetveten, por nuk dyshoi në ekzistencën e Allahut. Ai e beson Atë ashtu si muslimanët dhe pranoi se ishte fuqia e Tij që e vuri në rrugë të mbarë dhe mbolli në zemrën e tij besimin tek Ai.²¹

Këtë fakt e ka komentuar edhe Vexhi Demiri, kur shkruan: *"Gazaliu gati gjashtë shekuj para Dekartit ka qenë i mendimit se, që të arrihet bindja, duhet që studiuesi të vërë në dyshim të gjitha idetë që ka fituar, pastaj t'i rishikojë e t'i rikontrollojë ato për të gjetur gabimin".*²²

Mendimtarët e filozofët muslimanë të Andaluzisë (Spanjës)

Në anën perëndimore të Botës Islame, në Gadishullin Iberik, klima kulturore dallohet nga ajo e Lindjes. Që këtej Islami ka depërtuar edhe në Europën Perëndimore, megjithëse ka patur tendenca për ta eklipsuar e anashkaluar. Kur arabët depërtuan në tokën spanjolle në fillim të shek.VIII (viti 711 pas Krishtit), pa asnjë shenjë dhune, nisën të përhapnin vullnetarisht e me shpejtësi besimin islam. Muslimanët vinin atje si mbartës të një sekreti të cilin donin t'ua mësonin edhe të tjerëve, një porosi që ua kishte mësuar Profeti islam, Muhamedi (a.s): "Nuk ka ndryshim i bardhi me të ziun veçse (ndryshimi qëndron në atë) sa ai është i devotshëm në rrugën e Tij." Islami në këto anë u prit me bujari dhe u konsiderua si risi, prandaj u përqaftua brenda një kohe të shkurtër. Spanja përvetësoi kulturën e re pa prekur origjinalitetin, pa cënuar aspak brendinë, kështu lindi me shkëlqim të madh kultura islame e Perëndimit e ku lulëzuan shkencat e artet, u ndërtuan qytete, universitete e monumente hijerënda, që edhe sot (ata që kanë mbetur më këmbë) e mahnisin vizitorin dhe e joshin me madhësinë e tyre. Në këtë

perlë të begatisë kanë lindur e janë kulturuar burra emërmëdhenj. Njëri nga mistikët e parë të Spanjës, Ibn Masarra (269 Hixhri, 883 pas Krishtit) me prejardhje joarabe, ka shkruar shumë libra, nga të cilët kanë mbetur: "Kitabut-tebsiri" (Libri i shpjegimeve) dhe "Kitabul hurufi (Libri i shkronjave)". Ibn Masarra vdiq në Sierra më 20 tetor 329/ 933.

Doktrina mbi "materien fillestare inteligjente" ka ndikuar tek filozofi ebraik Solon ben Gabirola në veprën e Ibn Arabiut dhe ka ndihmuar në rindërtimin e veprës së Ibn Masarras, mbi teoremën fizike të pesë substancave.²³

Dëshmia bindëse e ndikimit të shpirtit mistik të Ibn Masara brenda sufizmit spanjoll është pranimi i këtyre ideve nga shkolla almerite.

Almeria u bë qendra e të gjithë sufinjve spanjollë. Kështu, sufiu Ebul Abbas Ibnul Arifiu ka hartuar rregullën e re të jetës shpirtërore (tarikatis) të themeluar sipas teozofisë²⁴ së Ibn Masarras. Më vonë përmendim nxënësit e tij: Ebu Bekër el Mallkuini nga Granada si dhe Ibn Barraxhuni, emri i të cilit ndeshet edhe kur lexojmë Ibn Arabiun. Të mrekullon "akti" i kompaktimit të ndërsjellë të pikëpamjeve dhe ideve ndërmjet eksponentësh të njohur si gjurmues shkencorë, përqasjet dhe linjat e afërta botëkuptimore të kulturës islame në gadishullin Iberik, që zbulon H. Korben ndërmjet Ibn Arabiut, birit të pllajeve jug-lindore të gadishullit të Spanjës, një emër i lakuar dendur në literaturën islame, të Barraxhiut të Seviljes dhe të Ibnul Kajsit, që vazhdoi traditat e mësuesit të vet në qytetin Al Garb të Portugalisë. Ndërmjet këtij brezi në qytetin e Kordovës (Korduba) del personaliteti i njohur i shek X-XI i Islamit andaluzian, Ibn Hazmi, figurë komplekse me prirje europiane, teolog, historian, kritik, filozof. Hazmi mori mësim në Kordovë nga ekspertët më të shquar në të gjitha shkencat: në atë të Hadithit, (fjalët dhe porositë e H.Muhamedit a.s.), në filozofi, jurisprudencë islame (fikh), në medicinë, letërsi etj. Me librin e tij "Gjerdani i pëllumbeshës", Ibn Hazmi klasifikohet si njëri ndër më të suksesshmit e radhëve të shkrimtarëve të platonizmit islam, sikundër ishte edhe Ibn Davud Ispahani (297/909). Kronistët latino-europianë i transformonin emrat e shkencëtarëve islamë: Ibn Baxheh e thërrisnin Avempace, Ibn

Rushdin e kanë quajtur Averroes etj.²⁵

Kur shqiptojmë emrin e Ibn Rushdit, - shkruan H. Korben -, na del përpara syve personaliteti i fuqishëm dhe filozofi autentik, për të cilin shkencëtarët perëndimorë kanë dhënë shumë informacion, por mjerisht, në optikën europiane mungon ndjenja e respektit të perspektivës. Gjatë shek. XII dijetarët më të shquar të Spanjës islame: Ibn Tufejli, Ibn Baxhe, Ibn Rushdi kanë zhvilluar luftë të ashpër kundër botëkuptimit të Ptolemeut. Rezultati skajor i kësaj beteje shkencore do të jetë sistemi i El Bitruxhiut. Ibn Rushdi ka debatuar probleme të mprehta mistike. Forca dhe energjitë e tij intelektuale kanë frymëzuar breza dhe janë bërë baza të shëndosha, ku janë mbështetur dijetarët që erdhën më pas të shkencave islame. Averrosi mendon dhe është i bindur për këtë se: *“Zbulimi i pamenduar (i parakohshëm) i kuptimeve ezoterike (batini) i dispozitave religjioze të të paditurve dhe të dobtëve do të shkaktonte katasrofen më të keqe psikologjike në shoqëri.”*²⁶

Averrosi hedh idenë e nevojës së një trajtесе të menduar e në harmoni me mistikën e misticizmin islam. Ai jetoi tonet e jetës së Granadës e të Seviljes dhe u përfshi në dinamikën e saj progresive, ku u shfaqën edhe tiparet e vatrave mistike. Shkolla almerite spanjolle (që mori zhvillim në qytetin Almeria), si epiqendra ezoterike e sufizmit, ka ndikuar dhe ka arritur të komunikojë e të afrohet me shkencëtarët deri në shpirtin mistik të Ibn Masarras-it.

Në veprën e Henri Korbenit gjejmë të dhëna të tilla që asnjë nga perëndimorët nuk ka guxuar t'i publikojë. Ne nuk kemi informacion të mjaftueshëm për Korbenin, veç asaj që është bërë e njohur nga përkthyesi në faqen 445, në fund të librit e, megjithëkëtë, është e pashmangshme përshtypja se ky studiues bashkëkohës po ecën me kurajo dhe me vendosmëri “kundër rrymës”. Me punën e tij kërkimore ai evidenton shkëlqimin islam disashekullor të Spanjës islame dhe fundin e pamerituar, brutal dhe gjakatar të po kësaj Spanje të imponuar nga inkuizicioni terrorist katolik – european mesjetar. Çdo termë, çdo datë, çdo emër që ndeshet nga historia e qytetërimit islam, ku bën pjesë edhe sufizmi, përmban, fsheh dhe përfaqëson ngjarje, fenomene, zbulime të papritura dhe, që të gjitha së bashku, përbëjnë atë

që bëri “epokë”, qytetërimin e Islamit botëror, ku të gjithë ata shpirtra kanë dhënë ndihmesën e tyre.

Tarikatet

Shtrirja gjeografike e Islamit në tri kontinente donte të thoshte se ishte krijuar jo një perandori, por një kamp i fuqishëm, ku bënë pjesë popuj të racave, gjuhëve e kombeve të ndryshme, që i bashkonte Islami. Formimi i shteteve islame konsiderohej si një akt formal, se askujt nuk i duheshin kufijtë shtetërorë të cilët ekzistonin formalisht. Përmirësimi i kushteve ekonomike solli zhvillimin e shpejtë të qyteteve. Damasku, Kajroja, Aleksandria u bënë qendra të lulëzuara dhe, si rrjedhojë, u zhvilluan arsimit dhe kultura. Islami përhapej me shpejtësi, pa dhunë e pa asnjë imponim. Institucionet kulturore e arsimore, ngritja e xhamive dhe e universiteteve ndihmuan në kompaktësimin, masivizimin e shkencave dhe në vëllazërimin e njerëzve pa dallim. Veprimtaria kërkimore e dijetarëve në qendrat e vogla të banimit nuk u jepte mundësi atyre të këmbenin përvojën, kurse në qytetet e mëdha shkencëtarët i shndërruan faltoret në akademira e institucione kërkimore. Njerëzit kishin më shumë mundësi të merreshin me punë mendore. Kuptimi i jetës mbështetej në ideologjinë islame. Filozofia, logjika, teologjia e letërsia nuk mbetën më prapa se shkencat ekzakte. Në këtë kuadër, mistika, ndryshe nga disiplinat e tjera, po krijonte vatrat ku besimtarët tuboheshin, mësonin e stërviteshin kolektivisht. Për këtë qëllim, nuk mungonte baza teorike e përpunuar gjatë shekujve, po nuk mungonte as përvoja praktike e zbatuar nga murshidët (udhëheqësit shpirtërorë) me grupe të vogla. Në këto kushte, dolën në shesh tarikatet e para. Procesi i krijimit të tarikateve nuk futi asnjëri në siklet. Besimtarët i bindeshin shejhit, siç respekton fëmija prindërit. Mësimet e tesavvufit në teqe lartësonin metodat e edukimit e kulturën e dhënies së mësimi të moralit dhe i përsosën këto forma pedagogjike të të mësuarit vetëm në emër të Zotit. Sa kohë që përhapnin dritën e Kuranit dhe hadithet profetike, nuk kishte asnjë lloj keqkuptimi, asnjë lloj kontradikte mes tarikateve. Muridët (besimtarët që aderonin

në tarikate, ithtarët) përmbushnin me përpikëri detyrat fetare dhe viheshin në shërbim të nevojave, në ndihmë të të sëmurve etj. Tarikatet gjetën miratimin e qytetarëve. Mësimet e para në teqe ishin njohuritë fillestare të besimit në njësinë e Zotit (xh.sh) dhe dëshmia se Muhamedi (a.s) është profeti, i dërguari i Tij. Murshidi i mësonte muridit hollësi të tjera. Format e vjetra organizative të vëllazërive e ato të as'habi saffit u zëvendësuan me organizime më efikase. Studimet kanë rezultuar se janë shpallur 200 - 400 tarikate islame qëkur nisi procesi i institucionalizimit të grupeve mistike, por në statistikat zyrtare të këtyre organizmave janë njohur dymbëdhjetë tarikate.²⁷ Në librin "Tesavvufi dhe tarikate", në faqen 304 shkruhet: "Numri i tarikateve së bashku me degët dhe nëndegët e tyre ka arritur në 200". Fjala tarikat e ka prejardhjen nga fjala arabisht "tarik". Kjo fjalë ka dy kuptime: kuptimi i parë është "yll", kuptimi i dytë është "rrugë". Duhet patur parasysh se fjala "tarikat" nuk mund të shpjegohet me fjalën "sekt", e cila mbart edhe kuptimin e ndarjes, të veçimit, të shkëputjes. Mbështetur në librin "Hyrje në tesavvuf", u pa më e përshtatshme të jepen më poshtë në listën e tarikateve të pranishme në vendin tonë. Mjerisht, deri sot literatura e shkruar nuk na jep asnjë informacion për tarikate e nderuar Tixhani e Hajati, prandaj me keqardhje nuk janë përfshirë as formalisht në këtë material.

Tarikati "Kadiri". Është themeluar nga mistiku Abdulkadir Gejlaniu (vd. 562/1166), i cili thuhet se rrjedh prej familjes së Aliut dhe është shkolluar në Bagdat. Për disa kohë ka dhënë mësim në shkencat e hadithit, jurisprudencës islame, në mësimin e Kuranit etj. Gejlaniu ishte shumë i lidhur me Sheriatin, me tesavvufin e me shërbesat fetare. Tarikati Kadiri është përhapur në Afrikë e në disa vende të Lindjes. Në Shqipëri ka disa teqe. Teqja Kadiri e Tiranës është ndërtuar nga fillimi i shek XVII. Gjejlaniu ka qenë shumë i ditur dhe ka shkruar shumë libra. Vepra kryesore e tij është quajtur ajo me titull "El Menakib (Bëmat)".

Tarikati "Rifai". Është themeluar nga Sejjid Ahmet Er Rifai (512 -578 Hixhri/1118-1182 pas Krishtit), jurist, shkencëtar i Hadithit, sufi i njohur. Për Rifainë tregohen mrekullira dhe thonë se ka pasur shumë muridë. Botëkuptimi mistik (sufik) i tij

është i lidhur ngushtë me Kuranin. Ai shkruante: *"Feja islame është e përbërë prej "Dhahirisë" (të zbuluarës, ekzoterikes) dhe prej Batinisë (të fshehtës, ezoterikes). "Tesavvufi është disiplinë ezoterike" dhe shton "Tarikati është sheriat, kurse hakikati nuk e kundërshton askund sheriatin".*²⁸

Në Shqipëri njëri nga figurat më me emër të rifaizmit është sheh Ahmet Shkodra (1878-1927). Sheh Ahmeti ka shkruar disa libra me poezi mistike e patriotike shoqërore. Ka edhe botime në prozë. Ilahitë e sheh Ahmetit shquhen nga toleranca dhe nga pjekuria e shprehjes së qëndrimeve doktrinale dhe bie në sy simpatia e hapur ndaj të katër as'habëve të mëdhenj. Monografia me titull "Jeta dhe veprimtaria e sheh Ahmet Shkodrës" shkruar nga Faik Luli dhe Islam Dizdari na jep një pasqyrë të gjallë të veprimtarisë së këtij mistiku shqiptar.

Tarikati "Halveti". Është themeluar nga Ebu Abdullah në vitin 1313. Halvetitë i japin shumë rëndësi pastrimit të zemrës, përkujtimit të pandërprerë të Allahut (dhikri) dhe dëshmisë, largimit prej "masivas" (të gjitha gjërat, përveç Zotit); e thënë ndryshe: "Zoti përveç çdo gjëje tjetër" e që nënkupton parimin sufrit: "Çdo gjë tjetër është asgjë, nuk ka vlerë, përveç Zotit; vetëm Ai është". Ky tarikat ka shumë degë.

Tarikati "Bektashi".²⁹ Rendi Bektashi është themeluar nga Haxhi Bektash Veliu (378 /1337,1338). Kapitulli i tretë i "Makalatit (Thëniet)" i kushtohet dispozitave islame që kanë të bëjnë me faljen (namazi), agjërimin dhe fjalën e dëshmisë. Me këto tri detyra detyrohen të gjithë besimtarët muslimanë, ndërsa zekati e haxhi janë të detyrueshme vetëm për ata muslimanë që plotësojnë kushtet ekonomike financiare. Kapitulli i katërt merret me pozicionet dhe rrugët që ndjekin sufijtë bektashë. Ata nuk kanë ndryshim me praktikën e tarikateve të tjera islame. Në "Makalat" shkruhet: "Nëse bektashiu nuk përmbush detyrat, quhet i dalë nga rruga. Sipas etikës bektashiane, janë të dënueshme padrejtësia, aventura, falli, shpifja për një njeri të pafajshëm, pijet alkoolike, prostitucioni, vjedhja etj. Vlen të theksohet se libri me shumë vëllime "Makalati" i autorit Haxhi Bektash Veliu është më i rëndësishmi nga veprat e këtij autori. Ky libër është përkthyer në gjuhën shqipe nga dr. Metin Izeti dhe është botuar në Tetovë më 2006.

Të gjitha tarikatet islame në Shqipëri kanë dhënë ndihmesë të rëndësishme në fushën e të drejtave kombëtare; në veçanti, bektashinjtë kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e identitetit për pavarësinë shtetërore dhe në përhapjen pa dhunë të Islamit në Shqipëri.³⁰

Jashtë tarikatit

Në Shqipëri janë marrë me mistikën edhe persona të tjerë jashtë tarikatit, që nuk bënin pjesë në tarikate. Ata janë paraqitur me shkrime në organet e shtypit islam.

Tesavvufi u bë baza ideologjike e teqeve qëkur lindën tarikatet, por kjo nuk do të thotë se misticizmi u përket vetëm personave, piranëve,³¹ murshidëve edhe në rastet kur njëri apo tjetri nga themeluesit apo ekspertët e sekteve në fushën e edukimit të muridëve e të dervishëve³² sillnin teorira të reja, teza origjinale, që përbënin risi në kërkimet për përsosjen e mëtejshme të kulturës ezoterike (dahili). Kjo dukuri, sipas meje, është manifestuar edhe pas krijimit të tarikateve, ndoshta edhe në trojet shqiptare.

1. Hafiz Ali Korça, p.sh. është njëri nga figurat me veprimtari të madhe të Islamit shqiptar; i përket spektrit *suni*, ai nuk bënte pjesë në asnjë tarikat dhe këtë gjë tek ne askush nuk e vë në dyshim. Po pikërisht ky Hafiz, qysh në vitin 1910 i dhuroi publikut shqiptar librin "Treqind e tri fjalët e Imam Aliut", shkruar me alfabetin e shoqërisë "Drita" të Stambollit. Si përfaqësues i rendit të parë të kulturës islame shqiptare, Hafiz Aliu është përfaqësuesi më i arrirë i filozofisë islame, fillimet e së cilës mund të kërkohen tek autorët shqiptarë islamë në rezidencën e pashallëkut të Shkodrës e ndoshta edhe më gjerë, sepse nuk kanë munguar njerëz të mësuar e të ditur, edhe në qytete të zhvilluara të vendit tonë deri në daljen në skenën e historisë të të ashtuquajturës "Periudha e Bejtexhinjve" me Nezimin mistik e emra të tjerë të përveçëm. Mendimi ynë është se ky proces dhe kjo ecuri ka njohur një linjë të pandërprerë edhe në drejtim të filozofisë e të tesavvufit- paralelisht me zhvillimin e Islamit në përgjithësi.

2. Ferid Vokopola, njëri nga personalitet më të shquara të

kulturës sonë, patriot e veprimtar i njohur, ka trajtuar me shkrim tema teorike për misticizmin dhe poezi me frymë mistike. Ai nuk kishte atributet e një prijësi tarikatesh. Le të kujtojmë krijimtarinë e poetit tonë kombëtar Naim Frashëri, ku fryma mistike bie qartë në sy, edhe pse ai nuk ishte as baba, as funksionar bektashi.

3. Një tjetër emër i njohur në rrafshin islam shqiptar është edhe Hafiz Raif Kadiu, ish-Muftiu i qytetit të Peshkopisë, që ka përkthyer në gjuhën shqipe librin "Menakib", kryevepra e prijësit të tarikatis Kadiri, Abdyl Kadir Gjejlaniut.³³

4. H. Raif Kadiu nuk ishte sheh; përkundrazi, ishte funksionar i lartë i Komunitetit Musliman Shqiptar.³⁴

Autorë të tjerë të brezit të ri të kohës kanë trajtuar e zhvilluar temën e misticizmit me shkrimet e tyre në organet publicistike islame shqiptare, si: "Zani i Naltë", "Kultura Islame" e revista "Njeriu". Tek kjo e fundit vlen të përmendim ish-studentin e Kajros, Sadik Bega. Në "Zani i Nalte" dhe në revista të tjera përmendim të tjerë anonimë me shkrimet:

1. "Misticizmi dhe roli i tij në historinë islame" nga Veritas.³⁵

2. "Përcaktimi i misticizmit" nga Shpeshi.³⁶

3. "Si e kanë predikuar bektashizmin teologët e këtij sekti"³⁷ etj.

Këto argumente na japin edhe një mesazh të kuptueshëm, atë që muslimanët shqiptarë, nëpërmjet atyre penave të respektuara të kulturës shqiptare kanë dhënë ndihmesën e tyre edhe në fushën e Tesavvufit, pastaj, në sajë të dispozitave islame, ruajnë marrëdhënie të shkëlqyera, të ndërsjella mes tarikateve dhe gjithë mozaikut fetar në Shqipëri, ashtu siç porosit Kurani: "*Mbahuni(kapuni) në rrugën e Zotit dhe mos u përçani!*"³⁸

Përfundime

Duke u mbështetur në të dhëna historike e në literaturën që disponohet, arrihet në disa përfundime:

1. Tarikatet e themeluara nga emra të njohur të kulturës islame kanë luajtur rol pozitiv e të dobishëm në fushën e edukimit të muslimanëve me normat e moralit islam.

2. Në vendin tonë drejtuesit e teqeve, shehlerët kanë shërbyer edhe si vaiza konferencierë, që trajtojnë tema fetare e sociale islame si hatibë (predikues islamë) e imamë xhamish (drejtuesi i faljeve në xhami), të emëruar zyrtarisht nga instancat zyrtare të administratës, si sheh Qazim Hoxha në Tiranë, sheh Selimi në Peshkopi, sheh Veliu, sheh Hysejini në rrethin e Tiranës etj.

Prandaj: *Misticizmi nuk ka arsye të konsiderohet si një e drejtë ekskluzive vetëm e tarikateve dhe e drejtuesve të tyre, sepse me mistikën janë marrë edhe persona jashtë lidhjeve me tarikatat.*

Tarikatat janë pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e besimtarëve të komunitetit musliman dhe vazhdojnë të japin ndihmesën e tyre me mesazhet që ato përcjellin në masën e besimtarëve.

Për përmbushjen e misionit që ata kanë marrë përsipër me përkushtim, ndihet nevoja e ngritjes arsimore e kulturore në nivele më të larta si e kuadrit drejtues, ashtu edhe e personelit që mund të shërbejë për edukimin dhe arsimimin e mëtejshëm të anëtarëve të kolektivave të institucionit të tyre, që t'i vihet më mirë në ndihmë shoqërisë, kombit e atdheut. Sa të jetë e mundur, tarikatat duhen mbajtur afër e duhen ndihmuar me durim; vetëm për hir të Islamit. Kjo le të konsiderohet si një obligim, si një detyrë e përhershme dhe e vazhdueshme, duke u mbajtur në rend të ditës nga të gjitha institucionet islame tek ne.

¹Hasan Kamil Yilmaz , "Anahatlariyla Tasavvuf (Hyrje në tesavvuf)", përkthyer nga dr. Metin Izeti, Tetovë 2002, fq. 28.

²Po aty, fq. 22.

³Po aty, fq. 36.

⁴Dr. Selçuk Eraydin, "Tesavvuf ve tarikatarlar (Tesavvufi dhe tarikatat)", përkthyer nga dr. Metin Izeti, Tetovë 2001, fq. 40.

⁵Dr. Selçuk Eraydin, vep. e cit., fq. 9.

⁶"Sunnet" përmbledh porositë dhe veprimet e Profetit Muhammed etj. H. Kamil Yilmaz, vep e cit. fq.28.

⁷Shifra e parë tregon vitin hixhri, shifra e dytë shënon vitin grigorian, që tek ne është zakon të shoqërohet me fjalët "pas Krishtit".

⁸ H. Kamil Yilmaz , vep. e cit., fq. 31.

⁹ Sadik Bega, "Zani i Naltë", viti XII i botimit, nr 12, Dhjetor 1937.

¹⁰ As'hab es-suffa: Suffa, quhej këndi i xhamisë së Profetit (a.s.) në Medinë, ku qëndronin përkohësisht mahaxhirët që nuk kishin shtëpi. Kur gjenin shtëpi, ata largoheshin prej aty. Profeti (a.s.) i ndihmonte edhe duke u dhënë për të ngrënë.

¹¹ Sadik Bega : "Zani i Naltë", viti XII i botimit, nr 12, Dhjetor 1937.

¹² Një gradë e lartë shpirtërore, që fjalë për fjalë do të thotë: Grada e qëndrimit me Zotin.

¹³ Sheh Qazim Hoxha "Ç'urdhëron Kurani <vazi>", konferencë e mbajtur në xhami, revista ""Zani i Naltë", viti XIII, qershor 1938, fq. 167. Sipas Sheh Qazim Hoxhës: "Mekami Beka" është grada më e lartë e Islamit.

¹⁴ H. Kamil Yilmaz, vep. e cit. fq. 76-79.

¹⁵ H. Kamil Yilmaz , "Hyrje në Tesavvuf", fq. 15 -16.

¹⁶ Po aty, faqe 36

¹⁷ Thomas Carlyle, "Heroi Profet, Muhammedi dhe islamizma", përkthyer në shqip nga Beqir Çela, Durrës, 1935.

¹⁸ H. Kamil Yilmaz, vep. e cit. fq. 48-49.

¹⁹ Henry Corben, "Historie de la philosophie islamique, Editions Gallimard 1986, (Historia e filozofisë islame)", përkthyer nga Nexhat S. Ibrahim, Shkup 1996, fq. 199.

²⁰ Muhamed Ali Karaati, "Ihjaul Gazali", botuar në gjuhën arabe në Kajro më 1935, paragrafi 29, fq. 72.

²¹ Hafiz Ismet Dibra "A ka dyshim në qenien e Zotit?!", Micigan 1993, fq. 68-72.

²² Vexhi Demiri, "Filozofët muslimanë, Gazaliu", Prizren, 1990, fq. 54. Për këtë, shiko edhe revistën "Kultura Islame", viti V i botimit, nr 7-8, mars-prill 1944 (Rebiul Evvel -Rebiul Akhar 1363 H., fq. 185.)

²³ H. Corben, vep. e cit., fq. 236-237.

²⁴ A. Fjalë nga greqishtja e lashtë, ka kuptimin: urtësi, mençuri sipas së cilës mistiku fetar e besimtar mund të njihet me Perëndinë e të bashkohet me të.

B. 1 - Teozofi,-a f. (gr. theosophia < theos+sophia) - Të njohurit e Zotit, nëpërmjet përceptimit të drejtpërdrejtë shpirtëror dhe zhytjes në vetvete dhe në botën abstrakte (metafizike) (sistemi i mistikës religjioze). (Instituti Albanologjik i Prishtinës: "Fjalori i fjalëve të huaja", Rilindja, Prishtinë 1988.)

2 -Teozofi,-a (gr. theos-Zoti dhe sophia-urtësia) - Pikëpamje filozofike spiritualiste e ezoterike, sipas të cilës vetëm Zoti është i urtë dhe kjo urtësi hyjnore mund të njihet e të përceptohet jo me anë të mendjes, të arsyes e të filozofisë, por me anë të shikimit tonë, që i drejtohet brendisë sonë, përkatësisht me anë të intuitës, pastaj me anë të ekstazës, zbulesës mistike të vërtetë (Prof. dr. Ekrem Murtezai: "Fjalori i feve", Rilindja, Prishtinë 2000.)

²⁵ H. Corbin, vep. e cit., fq. 237-239, 242.

²⁶ H. Corben, vep. e cit., fq 257.

²⁷ H. Kamil Yilmaz, vep. e cit. fq. 199.

²⁸ Dr. Selçuk Eraydin, vep. e cit., fq. 416.

²⁹ Sipas librit "Makalat" (Thëniet)", përkthyer në shqip nga dr. Metin Izeti 2006.

³⁰ Ali Basha, "Nëpër gjurmët e Islamit", Tiranë, 2005.

³¹ "Pir" quhet themeluesi i një tarikati.

³² Dervish-i, fjalë me prejardhje nga persishtja: prag-u. Në historinë e tesavvufit e ka kuptimin njeri i përkushtuar në shërbim të nevojtarëve në emër të Zotit, njerëz që falen shumë, ushqehen me sa më pak dhe vishen me rroba pa zbukurime, të arnuara e të vjetra. Ata bëjnë më shumë për të tjerët se sa për veten e tyre.

³³ Revista "Njeriu", nr. 9, mars 1943, viti i I, fq. 15.

³⁴ Kështu titullohej në atë kohë Komuniteti Musliman i Shqipërisë.

³⁵ Pseudonim i pazbardhur ende nga ne, në revistën "Njeriu", korrik-gusht 1941.

³⁶ Pseudonim tek "Njeriu", viti i II i botimit, Korrik 1943.

³⁷ Ali M. Basha, "Drita islame", viti V i botimit, nr. 5 (88), mars 1966.

³⁸ H. Sherif Ahmeti, Kurani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, surja 3, ajeti 103.